



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.363/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesues, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen të pabazuara ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.363/2025 dhe Anr.366/2025 të datës 04.02.2025, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe me seli në Mitrovicë të Veriut.

A r s y e t i m

-Me datë 04.02.2025 PZAP ka pranuar ankesën Anr.363/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 04.02.2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Zveçan kanë identifikuar banerë/posterë të vendosur në hapësirat/rrugët publike të subjektit politik Lista Serbe, në Zveçan në rrugën Krala Petra.

- Me datë 04.02.2025 PZAP ka pranuar ankesën Anr.366/2025 nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 04.02.2025, aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje në Zveçan kanë identifikuar banerë/posterë të vendosur në hapësirat/rrugët publike të subjektit politik Lista Serbe, në Zveçan në rrugën KKneza Milosa.

Sipas parashtruesit të ankesës me këtë veprim subjekti politik Srpska Demokratija, ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP, ku parashihet se “Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose

ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”

Si provë ka bashkangjitur, fotografit që dëshmon vendosjen e banerave/posterave në kundërshtim me LZP.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur, subjekti politik Lista Serbe ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dhe kanë theksuar se lidhur me ankesën e parashtruar materiali i paraqitur në pamjet e dorëzuara, i cili pretendohet se është vendosur si material promovues i partisë sonë, Listës Serbe, në fakt nuk është materiali ynë zgjedhor dhe se bëhet fjalë për materiale promovuese të subjekteve të tjera politike, dhe jo materiale të partisë sonë. Konkretisht, nga fotografitë që e dorëzuara, shihet se posterat dhe materialet e tjera janë të shënuara qartë me simbolet dhe emrat e partive që nuk janë të lidhura me Listën Srpska, duke bërë të qartë se ato nuk janë materialet tona promovuese të vendosura në hapësira publike, dhe Prandaj, besojmë se ankesa nuk pasqyron sakët gjendjen faktike, prandaj ju ftojme ti rishqyrtoni provat e bashkangjitura, duke marrë parasysh faktin se nuk janë materialet tona zgjedhore.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.363/2025,dhe A.nr.366/2025, të paraqitura me datë 04.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.363/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik LVV kundër subjektit te njëjtë politik Lista Serbe, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesave si dhe nga përgjigjet në ankesë, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se pretendimet e parashtruesit te dy ankesave të cekura më lartë janë te pabazuara. Për Panelin këto pretendime janë të pa bazuara, për faktin se posteret për te cilat pretendohen se janë te subjektit politik Lista Serbe, Paneli gjeti se te njëjtat nuk i përkasin dhe nuk janë të subjektit politik Lista Serbe.

Prandaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla të palës ankuese janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi të pabazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.363/2025 më datë 06.02.2025

Kryesues i Panelit
Violeta Husaj Rugova



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.